

VENDIM
Nr. 846, datë 28.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 452, DATË 11.7.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LENDFILLET E MBETJEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 43, pikat 6 e 7, 44, pika 3, 45 e 64, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun XI, të vendimit nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 25, fjalët: “... pavarësisht nëse ka ose jo leje mjedisi, deri në datën 31 dhjetor 2018” zëvendësohen me: “... deri në datën 31 dhjetor 2022”.

2. Pas pikës 25, shtohen pikat 25/1 dhe 25/2, me këtë përmbajtje:

“25/1 Në rast se operatorët e një venddepozitimi ekzistues nuk kanë burimet financiare ose aftësitë teknike për të përgatitur planin e përmirësimit të venddepozitimit me kërkesën e operatorit të venddepozitimit, plani i përmirësimit të venddepozitimit dhe rehabilitimi mund të kryhen nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

25/2 Planet e përmirësimit, të dërguara nga operatorët për miratim, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pas datës 31 dhjetor 2018, vlerësohen dhe miratohen nga Agjencia dhe kalojnë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.”.

3. Pika 28 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“28. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit, e dërgon atë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31 dhjetor 2024. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur miraton planin e përmirësimit, përgatit një relacion shpjegues teknik për Sekretariatit Teknik të Komitetit, i cili dërgohet së bashku me planin e përmirësimit. Relacioni shpjegues përmban të dhëna mbi pikëzimin e venddepozitimit, si dhe impaktin mjedisor, ekonomik e social të zonës ku ndodhet lëndfilli. Sekretariati shqyrton të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga AKM-ja dhe i përgatit një relacion përmbledhës Komitetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe